*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*

- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;*
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

*Sipas shtojcës 9, pika 1.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. OE duhet të paraqesë Bilancin e tre viteve të fundit të certifikuar nga tatimet.

2. Xhiroja mesatare e 3 (tre) viteve të fundit të jete jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit .

3. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

*4) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të ujit të pijshëm.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Ofertuesi duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit pa përfshirë vlerën e tvsh, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

***Për plotësimin e këtij kriteri OE duhet të paraqesë:***

– Në rast se furnizimet janë kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ENT publik për realizimin e kontratës, fatura tatimore shitje, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave si dhe të jete të firmosura nga të gjitha palet.

– Në rast se furnizimet janë kryer me sektorin privat:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon fatura tatimore shitje, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave si dhe të jete të firmosura nga të gjitha palet.

2.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e vlefshme të leshuar nga organizma të akredituara, që vërteton se sistemi i kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë së tij është në përputhje me **ISO 9001:2015** dhe objekti i saj të përputhet me mallin e kërkuar .

*Te gjitha certifikata ISO dhe standartet e kerkuara ne keto specifikime mund te zehendesohen me standarte ekuivalente ose standarte te tjera te pranuar nderkombetarisht qe sigurojne nje cilesi te barabarte ose me te larte se standartet e permendura.*

**Shënim:** Ky kriter kërkohet që OE është i certifikuar sipas standartit ndërkombëtar që produktet apo paisjet e sjella janë të garantuara në cilësi dhe nuk janë produkte të pakontrolluara apo të fallsifikuara.

3.Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën e vlefshme të leshuar nga organizma të akredituara, për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001:2004** për tregtimin dhe mirëmbajtjen e mallrave objekt prokurimi.

*Te gjitha certifikata ISO dhe standartet e kerkuara ne keto specifikime mund te zehendesohen me standarte ekuivalente ose standarte te tjera te pranuar nderkombetarisht qe sigurojne nje cilesi te barabarte ose me te larte se standartet e permendura.*

**Shënim:** Ky kriter kërkohet që OE është i certifikuar sipas standartit ndërkombëtar që produktet apo paisjet e sjella janë të garantuara në cilësi dhe nuk kanë ndikim në mjedis.

4.Operatori ekonomik ne oferten e tij duhet te plotesoj te gjitha kushtet dhe kerkesat e vendosura ne Specifikimet teknike ,shtojca 9 , dhe kur kerkohet, per te provuar perputhshmerine e produktit te ofertuar me kerkesat te paraqese certifikatat apo dokumentat provues ne varesi te produktit dhe kerkeses.

5.Ofertuesi duhet te paraqesi dokumenta teknike per artikujt te cilet jane objekt prokurimi si katalog apo frangmente katalogu/ skeda teknike te produkteve sipas preventivit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 9

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti: Materiale për mirembajtjen e rrjetit hidraulik për vitin 2020.

#### **A. Rakorderi PE me shtrengim për tubat e furnizimit me ujë.**

Për mirembajtjen e sistemit të furnizimit me ujë, lidhjet e shtepive në rastin kur do të përdoren rakorderite me shtrengim. Këto rakorderi duhet të përbehen prej polipropileni të një cilësie të lartë të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, kushteve të jashtme atmosferike. Të kenë një temperaturë pune  $-10$  në  $+ 45^{\circ}\text{C}$ , dhe të jenë të dizajnuara për të përballuar presione PN 16 bar.

Rakorderitë që përdoren janë të dimensioneve të ndryshme:

- Xhunto me dalje filete të tipit mashkull.
- Tee (tridegesha) me shtrengim.
- Tee me reduksion me shtrengim.
- Brryla me shtrengim  $90$  gradë.
- Bashkues të thjeshtë me shtrengim
- Reduksione të ndryshme.
- Fasheta me shtrengim me dalje fileto metalike të dimensioneve të ndryshme.

Rakorderite duhet të kenë të specifikuar në dokumentet shoqeruese përdorimin për ujë të pijshëm dhe aplikimin në sisteme ujësjellesi.

Rakorderite duhet të plotësojnë specifikime teknike:

- *Trupi dhe unazat shtrenguese*: Të përbehet nga material polipropilen me rezistencë të lartë mekanike dhe stabilitet termal.
- *Unazat e brendshme*: Të jenë material Polyacetal (POM) me ngjyrë të bardhë.

- *Gominat ne brendesi*: Te perbehen nga gome EPDM me ngurtesi 70 dhe te kene ngjyre te zeze.

Rakorderite duhet te plotesojne kerkesat e cilesise sipas standartit ISO 14236:2000 ose ISO 17885:2015 (*Per rakorderite dhe tubat plastike – Paisje me shtrengim mekanik per perdorim ne tuba presioni polyethylene ne sisteme ujesjellesi*) ose (*Sistemet me tuba plastik – Rakorderi mekanike per sisteme me tuba presioni*), ose çertifikime ekuivalente me objekt prokurimi te njejte te leshuara nga institucione te aprovuara vendase ose nderkombetare. Rakorderite duhat te plotesojne kerkesat per cilesine dhe testimin nga institucione te aprovuara sic jane: DVGW; WRAS; IIP; WM; Kiwa. ose standarte ekuivalente.

### **B. Rakorderi Zingato.**

Rakorderite duhet te jene çelik i bute i galvanizuar (GMS). Te kene te specifikuar perdorimin ne sisteme te furnizimit me uje.

Rakorderite qe perdoren jane te dimensioneve te ndryshme:

- Brryla zingato femer 90 grade te dimensioneve te ndryshme.
- Niples zingato e thjeshte dhe me reduksion.
- Tee zingato te thjeshta dhe me reduktim.
- Hollandez mashkull/femer dhe femer/femer.
- Manikota zingato te thjeshta.
- Reduksion zingato mashkull/femer dhe reduksion femer/femer.
- Tapa zingato.

Keto rakorderi duhet te kene siperfaqe te lemuar pa damare. Ne trup duhet te kene te markuar dimensionin, standartin (CE) dhe inicialet e firmes prodhuese.

Perberja e materialit duhet te siguroje aftesi te mira termike dhe te perballoje vibrimet. Materiali duhet te jete rezistent dhe te mos demtohet ose çahet gjate montimit.

*Materiali per rakorderite*: Duhet te jete sipas EN 1562; W 40-05 sipas ISO 5922:2005 ose standarte ekuivalente.

*Siperfaqja veshja me zink*: Duhet te jete sipas standartit EN 10242, pasha e veshjes se zinkut ne lidhje me siperfaqen te tejkaloje 500 gr/m<sup>2</sup> e cila korrespondon me nje trashesi mesatare 70 mikron. Siperfaqja e veshjes te zinkut duhet te jete rezistente ndaj korrozionit.

*Kushtet e presionit dhe te punes*: Rakorderite duhet jene rezistente ndaj presioneve te larta, por edhe kundrejt temperaturave. Materiali perberes duhet te kete karakteristika te tilla qe te perballoje presione qe arrijne ne 20 – 25 Bar dhe temperature -20 °C - 120 °C.

Testet e rjedhjes: Sipas EN 10242 Rakorderite duhet te kene kaluar testet e ajrit ne 5 bar i cili eshte ekuivalent me nje presion uji 20 Bar.



Ne menyre qe te sigurohet cilesia e produktit materialet duhet te shoqerohen me çertifikata si: ISO 9001:2015; ISO 14001 ; ISO 5922:2005 (per materialin perberes), ose certifikata te tjera ekuivalente nga institucione te aprovuara. Te plotesojne kerkesat per cilesine dhe testimin sipas DVGW ose standarte ekivalente.

### **C. Rakorderi Bronxi**

Rakorderite prej bronxi duhet te kene te specifikuar perdorimin ne tuba te furnizimit me uje te pijshem.

Rakorderite qe perdoren jane te dimensioneve te ndryshme.

- Brryla me shtrengim 90 grade dhe brryla me dalje me fileto femer.
- Xhunto me shtrengim dhe dalje fileto femer.
- Manikota me shtrengim nga te dyja krahet.
- Manikota me shtrengim me dalje fileto mashkull.

Rakorderite e bronxit duhet te jene te pershtatshme per tub polietilene dhe te perballojne presione deri ne 25 Bar. Te jene rezistente ndaj temperaturave -20 °C – 120 °C.

Per te siguruar cilesine e produktit keto rakorderi duhet te shoqerohen me çertifikata ISO 9001; ISO 7; ISO 228 ose certifikata te tjera ekuivalente nga institucione te aprovuara.

Te plotesojne kerkesat per cilesine dhe testimin sipas ANSI; JIS ose standarte ekivalente.

### **D. Tuba dhe rakorderi polipropilene (PPR)**

Tubat dhe rakorderite prej Polipropilene duhet te kene specifika per perdorim per uje te pijshem.

Tubat dhe rakorderite PPR duhet te jene sipas DIN 8077 and DIN 8078 dhe te jene te pershtatshme per instalime vertikale dhe deri ne vendin e matesit.

Tubat dhe rakorderite duhet te jene te prodhuar nga lenda e pare PP e klasit Tipi 3 (Polipropilene i zgjedhur Kopolimer), sipas standarteve EN ISO 15874, DIN 8077, DIN 8078, DVGW W544. Ose standarte dhe çertifikata ekuivalente nga institucione te akredituara.

Rakorderite qe perdoren jane te dimensioneve te ndryshme:

- Tubo PPR
- Brryla te thjeshte 45 dhe 90 grade.
- Tee e thjeshte dhe Tee me fileto femer.
- Reduktor PPR
- Tapa fundore
- Manikota te thjeshta dhe manikota me fileto femer.
- Brryla me fileto femer dhe mashkull 90 grade.
- Tapa ovale me dalje te ndryshme.

- Hollandez PPR me dalje fileto.
- Kalesa PPR.

Keto rakorderi duhet te rezistojne presioneve deri ne 25 Bar dhe mund te kene ngjyra te ndryshme si : e bardhe ,jeshile, gri, kafe e lehte, ose ngjyra te tjera.

Te gjitha tubat duhet te kene te shenuar ne trupin e tyre te dhenat si : *standartin , emrin e prodhuesit, llojin e materialit; diametrin e jashtem; presionin; daten e prodhimit; perdorimin; dhe informacionin mbi prodhuesin.*

Te gjitha rakorderite PPR duhet te kene te markuar ne trupin e tyre: *dimensionet sipas madhesisë , standartin CE si dhe prodhuesin.*

#### **E. Tubat dhe Rakorderi poliethyleni dhe elektrofuzioni (HDPE)**

Tubat dhe pajisjet PE duhet te jene ne perputhje me (DIN EN 12201, 2013-12), (DIN 8074, 2011-12), (DIN 8075, 2018-08) dhe (DVGW GW 335-A2, 2005-11) ose standarte te tjera te pranuar nderkombetarisht per te siguruar nje cilesi te barabarte ose me te larte se standartet e permendura.

Materiali i tubave duhet te jete HDPE 100 dhe lenda e pare e perdorur duhet te jete (DIN EN 12201, 2013-12) dhe duhet te jete nga lista PE 100+ e çertifikuar nga KIWA. Tubat dhe pajisjet duhet te kene aprovim per perdorim per uje te pijshem,dhe te jene rezistent ndaj rrezatimit UV ne perputhje me DVGW GW 335 A2, rezistent ndaj ngricave dhe i pershtatshem per ngjitje me elektrofuzion.

Tubat HDPE duhet te jene te pershtatshem te perballojne presione PN6, PN10, PN16, PN25, (SDR17, SDR11, SDR 5)Bar me nje factor sigurie  $c = 1,25$ .

Tubat duhet te dorezohen ne mbeshjtjellje ose shufra pa patur ndonje ngjitje:

- Min gjatesi tubi: 6 – 12 m per dimensione > OD 63mm.
- Mib gjatesi mbeshjtjelljes: 50 ose 100 metra per diametra deri ne OD 63 mm.

Çdo mbeshjtjellje (spirale) tubi duhet te jete e markuar sipas (DVGW GW 335-A2, 2005-11).

Ngjyra e siperfaqes se jashtme te tubave te furnizimit me uje te pijshem duhet te jete e zeze (RAL 9004) me vija blu (RAL 5005).

Ngjyrat duhet te korrespondojne afersisht me ngjyrat RAL te permendura me lart.

Tubat duhet te kene te shtypur ose printuar ne trupin e tyre informacionet si me poshte:

Keto informacione duhet te jene te shenuara qarte ne perputhje me DIN EN 12201-2.

- Emri i prodhuesit ose marka tregtare.

- Materiali.
- Dimensionet e jashtme dhe trashesia, spesori.
- Presioni ne Bar.
- Seria SDR sipas preventivit.
- Data e prodhimit.
- Perdorimi.
- Informacioni mbi prodhuesin.

Per sa i perket tubave me dimensione me te vogla me ambalazh spiral gjatesia e tubit duhet te jete e markuar ne trupin e tubit.

Tubat e ujit PE 100RC duhet te plotesojne standartet e instalimit ne kanale pa patur nevoje per mbrojtje me shtrese rere. Keto tuba duhet te kene rezistence te larte ndaj çarjeve dhe demtimeve.

- Rakorderite me ngjitje elektrofuzioni.

Rakorderite qe perdoren jane te dimensioneve te ndryshme:

- Manikota elektrofuzion.
- Fasheta elektrofuzion.
- Tee te thjeshta dhe me reduksion.
- Bryla elektrofuzion femer/femer 90 dhe 45 grade.
- Bashkues tranzitor me fileto mashkull.
- Tapa me ngjitje fundore.
- Fllanxha me ngjitje (spigot + unaze)
- Reduksione te ndryshme.

Te gjitha rakorderite do jene me material polietileni ngjyre e zeze PE-100, SDR 11 (PN 16) ,SDR 17(PN 10), dhe ne perputhje (DIN EN 12201, 2013-12), (ISO 4427-1-5 (2007-08)), (DIN 8074, 2011-12), (DIN 8075, 2018-08). Spiralja e brendshme e rakorderive duhet te jete e ngjitur forte pas trupit te tyre ne menyre qe gjate procesit te shkrirjes te siguroje nje ngjitje simetrike. Rakorderite duhet te kene nje thellesi te futjes ne tub (min D/3) dhe zonen shtese te shkrirjes dhe te ftohjes.

Per sa i perket bashkuesave ato duhet te kene nje unaze ne qender e cila ndihmon per te bere nje bashkim sa me centrik te tubit.

Te gjitha rakorderite elektrofuzive duhet te jene te pajisur me nje barkod te perhershem nga fabrika sipas standartit ISO (ISO 13950, 2007-03) ose ekivalente, i cili eshte rezistent ndaj agjenteve atmosferike dhe demtimeve. Barkodi duhet te mbaje te thena per kohen e shkrirjes, lexueshmerine nga pajisja e ngjitjes, kohen e ftohjes, diapazonin e tubave.

Barkodi duhet te lejoje automatikisht njohjen e pajisjes nga aparatuara e ngjitjes dhe te jete ne perputhje me (ISO 12176-4, 2003-11) ose ekuivalent.

Te gjitha paisjet duhet te jene te paketuara ne qese plastike transparente te pajisur me etikete e cila te permbaje te dhena per: llojin; dimensionet; materialin; normat nderkombetare dhe origjinen e produktit.

Te gjitha rakorderite me ngjitje duhet te jene rezistente ndaj presioneve SDR 11, PN16.

#### F. Rakorderi presioni DCI çelik + Gize

- Saraqineskat qe perdoren per komandimin e linjave kryesore duhet te jene sipas (DIN EN 1171, 2003-01) (DIN 3352-P4) me dimensione flanaxhe/flanaxhe (DIN EN 558, 2017-05)/GR-14 (versioni shkurter). Saraqineskat duhet te perballojne presione PN 10/16 dhe flanaxhat duhet te jene sipas (DIN EN 1092-2, 1997-06).Trupi i saraqineskes duhet te perbehet nga material (ductile cast) EN-GJS-400-18 sipas (DIN EN 1563, 2012-03).

Saraqineskat duhet te jene te veshura nga jashte dhe brenda sipas (DIN 30677-1, 1991-02).

Saraqineskat duhet te jene rezistente ndaj ndryshkut. Te kene te specifikuar perdorimin per uje te pijshem dhe operimin ne temperature deri 40 °C . Te gjitha saraqineskat duhet te furnizohen me numrin e duhur te bullonave , rondevleve dhe dado sipas vrimave ne flanaxhe.

Saraqineskat duhet ti perkasin nje klase qe ti rezistojte presioneve maksimale perfshire presionin e rritjes.Ato duhet te perballojne presione te njejta me linjen e tubit ku aplikohen.Te perballojne presione sipas zerit ne preventivit PN10/16.

Saraqineskat duhet te kene te derdhur ne trupin e tyre: presionin; dimensionet, gjithashtu te kene te ngjitur letren informuese qe permban marken ,dimensionet e jashtme dhe te brendshme specifikat per boshtin e komandimit dhe specifika te tjera.

- Gotat EU DN 150 per tub gize.

Gotat EU duhet te jene te prodhuara me çelik special (Ductil cast iron) dhe flanaxha te salduara sipas (EN 545, 2011-09). Materiali i prodhimit te jete kundra ndryshkut spas standartit (DIN EN 1563, 2012-03). Duhet te jete e veshur nga jashte me material pluhur epoxy sipas (DIN 30677-1, 1991-02)/ (DIN 3476-2, 2018-08). Flanaxhat e pjeses EU duhet te korrespondojne me nyjet e tubit te gizes dhe duhet te durojne presione te larta PN 40 Bar. Ne pjesen e brendshme duhet te kene gomine speciale me dhembeza metalike per te bere fiksimin ne tubin e gizes.

Ne trupin e pjeseve EU duhet te jete i markuar presioni dhe dimensionin. Duhet te plotesojne kushtet per perdorim ne linja ujesjellesi me presione te larta.

- Kutite plastike per matesat e ujit.

Dimensionet e kutise se matesit duhet te jene te pershtatshme per te mbajtur me shume se 1 mates uji nga 1/2" deri 2", ne varesi te llojit te lidhjes. Trashesia e materialit te kutise duhet te siguroje mbrojtjen e matesit dhe te rakorderive nga kushtet atmosferike.

Kutite duhet te jene te shoqeruara me kapake te klasave te ndryshme dhe te kene te vertetuar proven per ngarkesa (15 KN) dhe (125 KN) sipas EN 124. Kutia duhet te kete dimensione sipas zerit ne preventiv. Materiali te jete polietileni dhe polipropilen HDPE.

- Kutite per mates set (kapak + pusete).

Kutite metalike per montim ne mur. Kutite duhet te kene dimensione 50 x 40x 17 cm. Te jene te punuara me flete llamarine 2 mm dhe te jete e galvanizuar. Kapaku te kete montim me suste ne trupin e kutise dhe te jete e pajisur me çeles. Kutia te siguroje mbrojtje te matesit dhe rakorderive nga kushtet atmosferike. Preferohet qe keto lloj kutish te jene te izoluar me nje veshje te brendshme kundra klimes te ftohte.

- Saraqineske 1/2"; 3/4" ;1";1 1/2";2;2 1/2" me sfere

Saraqineskat te jene femer me sfere dhe mbyllja te behet me leve. Te jete e pershtatshme per furnizim me ujë, dhe rrjet ujesjellesi. Te plotesojne standrtat dhe specifikimet ISO 228 presion deri ne 50 bar. Temperatura e funksionimit: - 20C + 120C.

- Shiritat sinjalizues paralajmerues dy tipe:

- Shiritat te jene ngjyre blu dhe te kene te shkruajtur me ngjyre te zeze emertimin per ujesjellesa. Preferohet qe ky model shiriti te kete metal brenda.
- Shiriti sinjalizues i thjeshte duhet te kete ngjyra te bardha/portokalli ose bardhe/te kuqe ose ngjyra te tjera qe jane te pranueshme per punimet ne rruge. Shiriti duhet te kete dimensione 7.5 cm x 100 m dhe te jete i mbledhur ne mbajtese plastike me doreze.

*Te gjitha certifikata ISO dhe standartet e kerkuara ne keto specifikime mund te zevendesohen me standarte ekuivalente ose standarte te tjera te pranuar nderkombetarisht qe sigurojne nje cilesi te barabarte ose me te larte se standartet e permendura.*

*Certifikatat te kene te specifikuar objektin e prokurimit ose ekuivalent te ngjajshem.*

*Te gjitha materialet qe do te dorezohen duhet te vijne te ambalazhuara me ambalazhin perkates sipas specifikime te permendur me larte dhe te shoqerohen me tabelat perkatese informuese, certifikatat dhe standartet. Te shoqerohen nga dokumente qe konfirmojne perdorimin ne sisteme ujesjellesi dhe te ujit te pijshem.*

*Rakorderite te jene te shoqeruara me manualet dhe kataloget perkates.*

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet:

<b>NR</b>	<b>PËRSHKRIMI MATERIALEVE</b>	<b>NJËSIA</b>	<b>SASIA</b>
<b>A</b>	<b>Rakorderi PE me shtrengim</b>		
1	Xhunto Mashkull 20 x 1/2"	cope	250
2	Xhunto Mashkull 25 x 3/4"	cope	50
3	Xhunto Mashkull 32 x 1"	cope	45
4	Xhunto Mashkull 32 x 3/4"	cope	5
5	Xhunto Mashkull 40x 1 1/2"	cope	30
6	Xhunto Mashkull 50 x 1 1/2"	cope	50
7	Xhunto Mashkull 63 x 2"	cope	50
8	Xhunto Mashkull 75 x 2 1/2"	cope	15
9	Bashkues 20 x 20	cope	150
10	Bashkues 25 x 25	cope	40
11	Bashkues 32 x 32	cope	45
12	Bashkues 40 x 40	cope	30
13	Bashkues 50 x 50	cope	40
14	Bashkues 63 x 63	cope	20
15	Bashkues 75 x 75	cope	10
16	Fashete me shtrengim 40 x 1"	cope	10
17	Fashete me shtrengim 50 x 1"	cope	10
18	Fashete me shtrengim 63 x 1"	cope	30
19	Fashete me shtrengim 75 x 1"	cope	20
20	Fashete me shtrengim 90 x 1"	cope	10
21	Fashete me shtrengim 110 x 1"	cope	7
<b>SHUMA 01</b>			
<b>B</b>	<b>Rakorderi Xingato</b>		
22	Berryl Xingato Femer/Femer 1/2"	cope	130

Dokumentat Standarde të Tenderit

23	Berryl Xingato Femer/Femer 3/4"	cope	100
24	Berryl Xingato Femer/Femer 1 1/2"	cope	5
25	Berryl Xingato Femer/Femer 2"	cope	10
26	Berryl Xingato Femer/Femer 2 1/2"	cope	5
27	Berryl Xingato Femer/Femer 3"	cope	3
28	Nipel Xingato 1 1/2"	cope	10
29	Nipel Xingato 2"	cope	10
30	Nipel Xingato 2 1/2"	cope	5
31	Nipel Xingato 3"	cope	5
32	Tee Xingato 1/2"	cope	10
33	Tee Xingato 3/4"	cope	10
34	Tee Xingato 2 1/2"	cope	4
35	Hollandez Xingato Femer-Femer 1 1/4"	cope	3
36	Hollandez Xingato Femer-Femer 1 1/2"	cope	5
37	Hollandez Xingato Femer-Femer 2"	cope	15
38	Hollandez Xingato Femer-Femer 2 1/2"	cope	5
39	Hollandez Xingato Femer-Femer 3"	cope	3
40	Manikota Xingato 3/4"	cope	100
41	Manikota Xingato 1"	cope	30
42	Manikota Xingato 1 1/4"	cope	5
43	Manikota Xingato 1 1/2"	cope	5
44	Manikota Xingato 2"	cope	15
45	Manikota Xingato 2 1/2"	cope	8
46	Manikota Xingato 3"	cope	5
47	Reduksion Zingato femer-femer 3/4 x 1/2	cope	30
48	Reduksion Zingato femer-femer 1 x 1/2	cope	10
49	Reduksion Zingato femer-femer 1 x 3/4	cope	20
50	Reduksion Zingato femer-femer 1 1/2 x 1 1/4	cope	15
51	Reduksion Zingato femer-femer 2 x 1 1/2	cope	5
52	Reduksion Zingato femer-femer 2 x 1 1/4	cope	5
53	Reduksion Zingato femer-femer 2 1/2 x 1 1/4	cope	5
54	Reduksion Zingato femer-femer 2 1/2 x 1 1/2	cope	5
<b>SHUMA 02</b>			
<b>C</b>	<b>Rakorderi Bronxi</b>		
55	Xhunto me shtrengim femer 18 x 1/2	cope	40
56	Xhunto me shtrengim femer 32 x 1"	cope	20
57	Manikote me shtrengim 32 x 32	cope	15

Dokumentat Standarde të Tenderit

58	Manikote me shtrengim mashkull 18 x 1/2"		cope	40
59	Manikote me shtrengim mashkull 32 x 1"		cope	25
<b>SHUMA 03</b>				
<b>D</b>	<b>Tuba dhe rakorderi polipropilen (PPR)</b>			
60	Manikote PPR filet - femer $\phi$ 20 x 1/2"		cope	59
61	Manikote PPR filet - mashkull $\phi$ 20 x 1/2"		cope	60
62	Hollandez PPR $\phi$ 20 x 1/2"		cope	20
63	Hollandez PPR $\phi$ 32 x 1"		cope	10
<b>SHUMA 04</b>				
<b>E</b>	<b>Rakorderi polithyleni dhe elektrofuzioni</b>			
64	Tub HDPE $\phi$ 20 Pn 10/16 + bashkues EF		ml	1200
65	Tub HDPE $\phi$ 32 Pn 10/16 + bashkues EF		ml	500
66	Tub HDPE $\phi$ 63 Pn 10/16 + bashkues EF		ml	400
67	Tub HDPE $\phi$ 90 Pn 10/16 + bashkues EF		ml	100
68	Tub HDPE $\phi$ 22 Pn 10		ml	50
69	Tub HDPE $\phi$ 40 Pn 10		ml	500
70	Tub HDPE $\phi$ 50 Pn 10		ml	300
71	Manikota elektrofuzion $\phi$ 20		cope	235
72	Manikota elektrofuzion $\phi$ 63		cope	10
73	Fasheta elektrofuzion kit 63/20		cope	20
74	Fasheta elektrofuzion kit 90/32		cope	3
75	Brryl elektrofuzion femer 90° OD 20		cope	250
76	Brryl elektrofuzion femer 90° OD 63		cope	10
77	Bashkues tranzitor EF PE/metal M OD 20/1/2"		cope	150
78	Bashkues tranzitor EF PE/metal M OD 63/2"		cope	15
79	Redukson elektrofuzion 32/20		cope	80
<b>SHUMA 05</b>				
<b>F</b>	<b>Rakorderi presioni DCI Celik + Gize</b>			
80	Saraqineske Fllanxhe/Fllanxhe PN 10/16 $\phi$ 100		cope	2
81	Saraqineske Fllanxhe/Fllanxhe PN 10/16 $\phi$ 150		cope	2
82	Gote EU DN 150 per tub gize PN 40		cope	1
83	Gote EU DN 100 per tub gize PN 40		cope	1
84	Tub 1 fllanxhe PN 40 $\phi$ 100 L = 65 cm		cope	1



85	Kuti per mates plastike set (kapak + pusete) (50x40) h30	cope	30
86	Kuti per mates metalike set (kapak + pusete) (50x40)	cope	30
87	Boshte per saraqineska ø 160; ø 110; ø 90; ø 63	cope	15
88	Saraqineska me sfere 3/4 "	cope	20
89	Saraqineska me sfere 1 "	cope	15
90	Saraqineska me sfere 1 1/2 "	cope	10
91	Saraqineska me sfere 2 "	cope	10
92	Saraqineska me sfere 2 1/2 "	cope	5
93	Saraqineska me sfere 3 "	cope	3
94	Saraqineska me sfere 4 "	cope	2
95	Gomina ne qese 3/4"	cope	2
96	Shirit sinjalizues paralajmerues portokalli 7.5 cm x 100 m	cope	10

Afatet e lëvrim:

- a. Operatori ofertues i shpallur fitues duhet te furnizoje te gjitha artikujt e kerkuar **Brenda 15 diteve kalendarike** duke filluar nga dita e lidhjes se kontrates , te cilen duhet ta konfirmoje me *Deklarate te vecante* , se do te furnizoje te gjithe artikujt e kerkuar brenda 15 diteve kalendarike nga data e lidhjes te kontrates.

### Shtojca 11

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

#### PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____

...		
-----	--	--

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Me respekt  
< Emri >

### Shtojca 13

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyt e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

#### **Shtojca 14**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## **Shtojca 15**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë,

citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojë mbi KPK.

## **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifrat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupsuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtojë Autoritetin Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë



zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime

në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilesinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë përkatëse të kontratës.
